EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8427
E shtunë, 7 nëntor 2026
Çmimi 0. 50 €

Mbi 31 mijë vaksina kundër gripit sezonal janë administruar në Kosovë FAQE 6



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ÇFARË MUND TË NDRYSHOJË PËR KOSOVËN ME DEMOKRATËT NË KRYE TË KONGRESIT? FAQE 3



Me shumicën demokrate, Kongresi i ShBA-së mund ta shqyrtojë më nga afër politikën e administratës Trump ndaj Serbisë, thonë ekspertë amerikanë për REL-in. Ata presin që Uashingtoni t'u kushtojë më shumë vëmendje marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, por nuk presin ndonjë nismë të madhe diplomatike së shpejti. Sipas tyre, Kosova mund të marrë vetë iniciativën për t'i përmirësuar marrëdhëniet me serbët e Kosovës dhe për t'i forcuar lidhjet me ligjvënësit e të dyja partive në Kongres

AKTUALE



SHBA-ja PARAQET PLAN PËR SIGURINË EVROPIANE NË PRAG TË BISEDIMEVE PËR UKRAINËN F. 2

KOSOVA NIS PËRGATITJET PËR FONDET E REJA TË BE-SË PËR PERIUDHËN 2028-2034 F. 7

EKONOMI



SPANCA: REKOMANDIMET E AUDITIMIT ENDE NUK PO MARRIN VËMENDJEN NGA NJË PJESË E INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE F. 8

BQK-JA ZGJERON BASHKËPUNIMIN ME BANKËN E ITALISË EDHE NË FUSHËN E MBROJTJES SË KONSUMATORËVE FINANCIARË F. 8

BANKA ZHVILLIMORE MBETET PREMTIM EDHE PAS PESË VJETËSH F. 4



IKD-JA KËRKON PËRGJEGJËSI PENALE PËR MOSZBATIMIN E AKTGJYKIMEVE TË KUSHTETUESES, OPOZITA BËN THIRRJE PËR RESPEKTIMIN E TYRE F. 7



SPORT



FODA PUBLIKON LISTËN E KOSOVËS PËR NDESHJET NDAJ IZRAELIT DHE IRLANDËS F. 11

DIPLOMON GJENERATA E 63-TË E POLICISË SË KOSOVËS F. 5

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

SHBA-ja PARAQET PLAN PËR SIGURINË EVROPIANE NË PRAG TË BISEDIMEVE PËR UKRAINËN



UASHINGTON, 6 NËNTOR - Shtëpia e Bardhë ka paraqitur një plan-kornizë për sigurinë evropiane, së bashku me garancitë e sigurisë për Ukrainën, teksa administrata e presidentit Donald Trump po përgatitet për bisedime trepalëshe të paqes me Ukrainën dhe Rusinë, që do të mbahen javën e ardhshme në Abu Dabi.

I dërguari i presidentit amerikan, Trump, Jared Kushner, i paraqiti detajet e kësaj nisme përmes një postimi në rrjetet sociale më 5 nëntor, pas diskutimeve në Bruksel me zyrtarë ukrainas, të NATO-s dhe evropianë.

Korniza e propozuar përfshin konsultime të përhershme për sigurinë, komunikim në kohë krizash, transparencë më të madhe ushtarake, masa reciproke për të ulur rreziqet e përshkallëzimit, si dhe një marrëveshje afatgjatë për sigurinë dhe stabilitetin evropian.

Kushner tha se kjo nismë do të respektonte sovranitetin dhe integritetin territorial të çdo vendi, teksa asnjë shtet nuk do të kishte të drejtë vetoje mbi zgjedhjet e sigurisë apo aleancat e një shteti tjetër. Ai theksoi se NATO-ja do të mbetej në qendër të mbrojtjes kolektive evropiane.

Ky njoftim u bë pas takimit më 5 nëntor në Shtëpinë e Bardhë mes Trumpit dhe të dërguarit të posaçëm të presidentit rus, Vladimir Putin, Kirill Dmitriev. Trump tha se beson që një "marrëveshje e madhe dhe e shkëlqyer" mund të arrihet shpejt, duke sugjeruar se ajo mund të përfshijë jo vetëm Ukrainën, por "të gjithë Evropën". "Do të jetë një marrëveshje e madhe dhe do të përfshijë më shumë sesa Ukrainën", u tha Trump gazetarëve, duke parashikuar se "të gjithë do të jenë të kënaqur". Kushner tha se konsultimet do të vazhdonin përmes formatit të quajtur Shell Bay, ku përfshiheshin Ukraina, NATO-ja, Bashkimi Evropian dhe partnerët e tjerë evropianë, ndërkaq Rusia po ashtu do të merrte pjesë në negociatat për paqe.

Shqetësimet e sigurisë

Lidhja e propozuar mes garancive të sigurisë për Ukrainën dhe një arkitekture më të gjerë të sigurisë evropiane ka ngritur pikëpyetje në mesin e ekspertëve për Rusinë lidhur me shtrirjen e kësaj nisme dhe ndikimin e saj në NATO.

Glen Howard, president i Fondacionit Saratoga, njëherësh strateg për çështjet e Rusisë, i tha Radios Evropa e Lirë se njoftimi i Kushnerit mund të synojë që ta sigurojë Ukrainën dhe aleatët evropianë se Uashingtoni nuk po i braktisë interesat e tyre, teksa ushtron presion ndaj Rusisë para negociatave.

Por, Howard tha se referenca ndaj një arkitekture më të gjerë të sigurisë evropiane është veçanërisht shqetësuese.

Ai iu referua deklaratave të bëra javën e kaluar nga këshilltari i Kremlinit për politikë të jashtme, Yury Ushakov, i cili bëri thirrje që NATO-ja të kthehej në pozicionin që kishte para vitit 1997, përpara se aleanca të zgjerohej në Evropën Lindore dhe në shtetet baltike. "Që kur ka Rusia të drejtë të japë mendim për të ardhmen e NATO-s dhe për zhbërjen e krahut lindor të saj?", tha Howard, duke vënë në pikëpyetje se çfarë lëshimesh do të ofronte Rusia në këmbim.

Ai paralajmëroi se edhe vetëm vendosja e qëndrimit të NATO-s në tryezën e negociatave do të mund të krijonte një precedent për Rusinë dhe administratat e ardhshme amerikane.

Howard e krahasoi qasjen e mundshme me Marrëveshjen e Munihut të vitit 1938, e cila i lejoi Gjermanisë Naziste të aneksonte një pjesë të Çekosllovakisë, në këmbim të premtimit të Adolf Hitlerit se nuk do të kishte më pretendime territoriale. Ai po ashtu përmendi shqetësimet më të gjera lidhur me qëndrimin e administratës Trump ndaj Rusisë, përfshirë komentet e zyrtarit të lartë të Pentagonit, Elbridge Colby, i cili u bëri thirrje shteteve baltike të zbusin retorikën kundër Rusisë.

Ai sugjeroi po ashtu se përgatitjet e Francës dhe Britanisë për dislokimin e mundshëm të forcave paqeruajtëse në Ukrainë, si dhe diskutimet për ridrejtimin e gazit përmes Ukrainës, mund të jenë pjesë e një strategjie më të gjerë në kuadër të negociatave.

John Herbst, ish-ambasador i SHBA-së në Ukrainë dhe drejtor i lartë në Qendrën për Euroazinë të Këshillit Atlantik, u shpreh pak optimist lidhur me bisedimet e ardhshme.

Ai përmendi deklaratën e fundit të ministrit të Jashtëm rus, Sergei Lavrov, se Rusia nuk do të bëjë asnjë kompromis, si dhe raportimet për emërimin e Vladimir Medinskyt në krye të delegacionit rus në Abu Dabi. Medinsky më herët ka udhëhequr ekipet negociuese ruse, por në ato takime nuk është arritur ndonjë përparim.

Herbst tha se përfshirja evropiane mund të ndihmojë në ruajtjen e mbështetjes për Ukrainën dhe ta nxisë Uashingtonin të mbajë një qëndrim më të fortë.

Megjithatë, ai paralajmëroi se përpjekjet evropiane për të ndikuar tek administrata amerikane kanë pasur ndikim të kufizuar, krahasuar me aftësinë e Kremlinit për të ndikuar te Trumpi.

Ai ngriti pyetjen pse Uashingtoni po përqendrohej te marrëveshjet e sigurisë pas luftës dhe te shtensionimi i situatës, përpara se të siguronte një zotim të mirëfilltë nga Rusia për t'i dhënë fund luftimeve.

Herbst sugjeroi se refuzimi i Rusisë për të bërë lëshime e ka shtyrë administratën e Trumpit që të kërkojë përparim në fusha të tjera, në vend se të ushtrojë presion më të madh ndaj Kremlinit. Sipas tij, sfida është te hartimi i garancive mjaftueshëm të forta për ta siguruar presidentin ukrainas, Volodymyr Zelensky, por jo që ato të jenë aq të gjera sa Rusia të mund ta refuzojë një marrëveshje. "Kjo është një detyrë e pamundur", i tha Herbst Radios Evropa e Lirë, duke argumentuar se Rusia nuk dëshiron garanci serioze të sigurisë për Ukrainën, teksa Kievi ka nevojë për to në mënyrë që të mbijetojë si shtet i pavarur.

Sipas Herbstit, një përparim i mirëfilltë do të ishte një zotim i qartë i Rusisë për t'i dhënë fund luftimeve, gjë që ai e konsideron se ka pak gjasa që të arrihet. Ai tha se Putini ende synon që ta marrë Ukrainën nën kontroll dhe dëshiron që presidenti Trump ta bindë Kievin që të heqë dorë nga pjesët e Donbasit që ende janë nën kontrollin e Ukrainës.

Në pamundësi që ta pushtojë territorin përmes fushatës ushtarake, Putini mund të vazhdojë të sulmojë qytetet dhe infrastrukturën civile të Ukrainës, me qëllim që ta detyrojë Kievin të dorëzohet, tha Herbst.

Pritjet nga Abu Dabi

Bisedimet trepalëshe mes ShBA-së, Ukrainës dhe Rusisë janë caktuar që të mbahen më 10 dhe 11 nëntor dhe, sipas Kushnerit, ato do të jenë bisedimet e para të paqes që nga shkurti.

Mark Temnycky, bashkëpunëtor i jashtëm në Qendrën për Euroazinë të Këshillit Atlantik, i tha Radios Evropa e Lirë se pret përparim gradual, por jo ndonjë përparim të madh. Sipas tij, pengesat kryesore mbeten mosmarrëveshjet territoriale dhe siguria e Ukrainës pas përfundimit të luftës.

Që garancitë e sigurisë të jenë të besueshme, Uashingtoni dhe kryeqytetet evropiane duhet të pajtohen se si do të zbatohen ato dhe kush do të financojë rindërtimin e Ukrainës.

Grupi i Bankës Botërore, Komisioni Evropian, Kombet e Bashkuara dhe Qeveria e Ukrainës vlerësojnë se nevojat për rindërtimin e vendit gjatë dekadës së ardhshme arrijnë në rreth 588 miliardë dollarë.

Temnycky paralajmëroi se Uashingtoni nuk mund thjesht t'i ofrojë Ukrainës anëtarësimin në BE si pjesë e një marrëveshjeje. Vendimi për këtë çështje u takon të 27 shteteve anëtare të bllokut evropian.

Dy diplomatë të lartë evropianë në Uashington i thanë Radios Evropa e Lirë më 5 nëntor se udhëheqësit evropianë nuk besojnë se Rusia është e gatshme të bëjë lëshime lidhur me Ukrainën apo sigurinë evropiane.

Përpjekje paralele diplomatike

Aktiviteti i fundit diplomatik përkon me disa nisma të tjera që synojnë krijimin e një momentumi drejt arritjes së një marrëveshjeje.

Më 5 nëntor, zonja e parë e SHBA-së, Melania Trump, priti në Shtëpinë e Bardhë përfaqësues rusë dhe ukrainas për të shënuar një armëpushim gjashtëditor, që ajo e ndërmjetësoi në qytetin ukrainas Oleshki - të pushtuar nga Rusia - në rajonin e Hersonit.

Gjatë ndërprerjes së luftimeve, në fund të tetorit, nga ky qytet u evakuuan afër 800 persona. "Ne zgjodhëm humanitetin në vend të luftës", tha Melania Trump, duke u bërë thirrje palëve që ta shfrytëzojnë këtë nismë për të gjetur pika të përbashkëta, nisur nga shqetësimi për civilët.

Ndërkaq, Zelensky ka shkuar në Spanjë për bisedime lidhur me forcimin e mbrojtjes ajrore të Ukrainës dhe ai do të zhvillojë takime në kuadër të Samitit Ibero-Amerikan.

Ai tha se para negociatave në Abu Dabi është planifikuar që të ketë kontakte të tjera me zyrtarë amerikanë. "Po koordinohemi me partnerët tanë për të arritur rezultate konkrete në çështjet e sigurisë dhe për hapat e ardhshëm drejt paqes", shkroi Zelensky në rrjetet sociale.

Takimi i Trumpit me Dmitrievin po ashtu tërhoqi vëmendje, pasi i dërguari rus vazhdon të jetë nën sanksione të Departamentit amerikan të Thesarit.

Një zyrtar amerikan i tha Radios Evropa e Lirë se ky nuk është takimi i parë mes dy zyrtarëve i zhvilluar në Shtëpinë e Bardhë dhe hodhi poshtë pretendimet se sanksionet e kanë penguar Dmitrievin të udhëtojë drejt SHBA-së. Ai tha se janë lëshuar leje të posaçme për të mundësuar vizitën.

Deri më tani nuk është njoftuar për asnjë vendim zyrtar për heqjen e tij nga lista e sanksioneve amerikane.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

ÇFARË MUND TË NDRYSHOJË PËR KOSOVËN ME DEMOKRATËT NË KRYE TË KONGRESIT?

Me shumicën demokrate, Kongresi i ShBA-së mund ta shqyrtojë më nga afër politikën e administratës Trump ndaj Serbisë, thonë ekspertë amerikanë për REL-in. Ata presin që Uashingtoni t'u kushtojë më shumë vëmendje marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, por nuk presin ndonjë nismë të madhe diplomatike së shpejti. Sipas tyre, Kosova mund të marrë vetë iniciativën për t'i përmirësuar marrëdhëniet me serbët e Kosovës dhe për t'i forcuar lidhjet me ligjvënësit e të dyja partive në Kongres



PRISHTINË, 6 NËNTOR - Zgjedhjet e mesmandatit në ShBA ndryshuan raportin e forcave në Kongres, një zhvillim që mund të ndikojë edhe në politikën e jashtme amerikane. Por, çfarë konkretisht mund të ndryshojë në politikën e Uashingtonit ndaj Kosovës tani që demokratët fituan kontrollin e të dyja dhomave - Senatit dhe Dhomës së Përfaqësuesve?

Ekspertë amerikanë thonë për Radion Evropa e Lirë se kjo përbërje e re mund të sjellë një angazhim më të madh të Kongresit në Ballkanin Perëndimor, por insistojnë se pritshmëritë nuk duhet të jenë shumë të larta.

Robin Brooks, ish-drejtoreshë për Evropën Qendrore dhe Ballkanin në Këshillin për Siguri Kombëtare të ShBA-së, thotë se edhe pse Kosova nuk është në fokusin e përditshëm të shumicës së ligjvënësve amerikanë, ajo mbetet aleate e rëndësishme e Uashingtonit. Sipas saj, Kongresi i ri, që nis punën në janar të vitit të ardhshëm, fillimisht do të përqendrohet në çështjet e brendshme, si çmimet e larta, kostoja e barnave dhe karburanteve. Por, vendimet e administratës në politikën e jashtme mund të bëhen gjithashtu objekt shqyrtimi.

Ajo shpjegon se Kongresi do të mund ta mbajë administratën përgjegjëse nëse veprimet e saj bien ndesh me "ligjet, vlerat dhe normat amerikane". Kjo, thotë Brooks, mund ta përfshijë edhe mënyrën se si Uashingtoni u kërkon vendeve të tjera, si Kosovës, për bashkëpunim në çështje si dëbimi i personave nga ShBA-ja.

Edhe pse politika e jashtme mund të zërë pak vend në agjendën e Kongresit, ai mund të ndikojë më drejtpërdrejt në marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë.

Si mund të ndikojë ndryshimi në Kongres në raportet Kosovë - Serbi?

Edward P. Joseph, profesor në Universitetin Johns Hopkins, pret që Kongresi i kontrolluar nga demokratët do të ushtrojë më shumë presion për shqyrtimin e politikës së administratës Trump ndaj Serbisë. Sipas Josephit, zhvillimet politike në Serbi mund ta shtojnë këtë vëmendje dhe ta shtyjnë Uashingtonin të kërkojë një angazhim më të madh për stabilizimin e marrëdhënieve me Kosovën.

Në Serbi, fitorja e Listës Studentore në zgjedhjet e 25 tetorit i dha fund 14 vjetëve të qeverisjes së Partisë Përparimtare Serbe të Aleksandar Vuçiqit.

Për të përfituar nga këto rrethana, Joseph i bën thirrje kryeministrit të Kosovës, Albin Kurtit, që ta ndryshojë qasjen ndaj komunitetit serb në vend. "Kurti ka një mundësi të rrallë për të marrë iniciativën dhe për të propozuar politika të reja që do të përmirësonin marrëdhëniet si me serbët e Kosovës, ashtu edhe me Serbinë. Nga ana tjetër, nëse vazhdon me qasjen aktuale, Kosova do të përballet me presion dhe kritika më të mëdha", thotë Joseph për REL-in.

Ndër vite, Kurti është kritikuar vazhdimisht nga SHBA-ja dhe BE-ja për "veprime të njëanshme" në veri, të marra pa koordinim me aleatët perëndimorë, të cilat, sipas tyre, kanë rritur tensionet dhe pasigurinë te serbët e Kosovës.

Edhe Daniel Fried, ish-ambasador amerikan dhe ish-zyrtar i lartë i Departamentit të Shtetit, sheh në njëfarë mase mundësi për "diplomaci më kreative" në rajon, pas ndryshimit të pushtetit në Serbi dhe humbjes së kontrollit republikan në Kongresin amerikan. "Nuk do të prisja një nismë të madhe së shpejti", thotë ai për REL-in, duke shtuar se, megjithatë, mund të ketë bashkëpunim më të ngushtë të SHBA-së me Evropën për ta orientuar Serbinë drejt integrimit evropian.

Sipas tij, Kosova mund të përpiqet të mos shihet vetëm përmes mosmarrëveshjeve me Serbinë dhe të forcojë marrëdhëniet e veta me Uashingtonin, por për këtë kërkohet iniciativë nga vetë Kosova. "Kosova duhet të mbështetet edhe më shumë te parimet e saj themeluese: demokracia, sundimi i ligjit dhe flamuri i saj (i mrekullueshëm), që e përfaqëson Kosovën si shtet për të gjithë ata që jetojnë në të", thotë Fried.

Brooks, ndërkaq, argumenton se Kosova nuk duhet ta lidhë politikën e saj të jashtme vetëm me administratën aktuale amerikane.

"Përpjekja për t'i bërë qejfin administratës Trump ishte gabim që nga fillimi", thotë ajo.

Sipas Brooks, kjo qasje e ka futur Kosovën në iniciativa që nuk i kanë sjellë domosdoshmërisht përfitime afatgjata, si Bordi i Paqes. "Kosova duhet të kërkojë të ardhmen e saj evropiane dhe të angazhohet me të dyja partitë në Dhomën e Përfaqësuesve dhe në Senat", thotë ajo.

Një prej çështjeve ku ligjvënësit amerikanë mund të ndihmojnë, sipas saj, është bindja e pesë vendeve të Bashkimit Evropian - Spanja, Greqia, Rumania, Qipro, Sllovakia - që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës që ta bëjnë këtë.

Partneriteti strategjik ndërmjet FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës, Maqedonci nderon gjeneralin Osborn

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Ministri Maqedonci mirëpriti agjutantin e përgjithshëm të Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneralmajor Stephen E. Osborn, të cilit i shprehu mirënjohjen për angazhimin e vazhdueshëm dhe kontributin e çmuar në mbështetje të Forcës së Sigurisë së Kosovës si dhe në avancimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shtetit të Ajovës.

Në shenjë vlerësimi për shërbimin e tij të shquar, përkushtimin dhe kontributin në zhvillimin dhe avancimin e kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, e nderoi gjeneralmajor Osbornin me Medaljen "Shërbim i Shquar" i Ministrisë së Mbrojtjes.

Partneriteti me Gardën Kombëtare të Ajovës ka luajtur rol të rëndësishëm në procesin e transformimit, profesionalizimit dhe ngritjes së kapaciteteve operacionale të FSK-së.

Ky bashkëpunim përbën një dëshmi të partneritetit strategjik dhe marrëdhënieve të fuqishme ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që mbetet aleati ynë kryesor për zhvillimin dhe fuqizimin e FSK-së.





BANKA ZHVILLIMORE MBETET PREMTIM EDHE PAS PESË VJETËSH

Gjashtë vjet pas premtimit, Banka Zhvillimore në Kosovë nuk është themeluar ende dhe nuk ka afat për funksionalizimin e saj. Bizneset kërkojnë kredi me interesa më të ulëta dhe afate më të gjata kthimi për të investuar në prodhim. Kosova ka mbi shtatë miliardë euro kredi, por sektori i tregtisë vazhdon të marrë dyfish më shumë financim sesa prodhimi

Prishtinë, 6 nëntor - Kreditë bankare janë një nga burimet kryesore të financimit për bizneset prodhuese në Kosovë, por normat e interesit dhe afatet e kthimit shpesh ua vështirësojnë investimet për zgjerimin e prodhimit.

Shpejtim Kuçi, drejtor menaxhues i kompanisë së këpucëve "Solid Shoes" në Suharekë, thotë se bizneset duhet ta fillojnë kthimin e kredive para se investimet të gjenerojnë të ardhura.

Blerja dhe instalimi i makinerive, nisja e prodhimit dhe shitja e produkteve kërkojnë kohë, ndërsa kështet e kredisë fillojnë të paguhen më herët. "Dhe ende pa siguruar të hyra apo fitim, në muajin pasues duhet të fillojë pagesa e kështit të kredisë, me kamata të larta. Kjo është e papërballueshme për shumë biznese", thotë Kuçi për Radion Evropa e Lirë.

Edhe kompania që ai drejton ka kredi bankare.

Kuçi beson se një bankë zhvillimore, me interesa më të ulëta dhe afate më të gjata kthimi, do t'u mundësonte prodhuesve të investonin më shumë. Por, sipas tij, Kosova është vonuar në krijimin e një institucioni të tillë.

Themelimi i Bankës Zhvillimore është një nga premtimet e kahershme të Lëvizjes Vetëvendosje.

Gjashtë vjet pas fillimit të qeverisjes së saj të parë, banka ende nuk është themeluar.

Qeveria ka ndërmarrë disa hapa përgatitorë, por ende nuk dihet se sa do të kushtojë krijimi i saj, si do të financohet dhe çfarë kushtesh do t'u ofrojë bizneseve.

Ekspertët e ekonomisë vlerësojnë se banka mund të ndihmojë investimet dhe prodhimin vendor, por paralajmërojnë se rezultatet do të varen nga menaxhimi profesional dhe pavarësia nga ndikimet politike.

Miliarda euro kredi, por prodhimi mbetet prapa tregtisë

Vlera e kredive në Kosovë është rritur ndjeshëm vitet e fundit. Sipas Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), në gusht të këtij viti, kreditë e qytetarëve dhe bizneseve tejkaluan shtatë miliardë euro, nga të cilat mbi katër miliardë euro u përkisnin bizneseve.

Tregtia prin me mbi 1.6 miliard euro kredi, ndërsa sektori i prodhimit ka marrë rreth 800 milionë euro.

Bizneset paguajnë mesatarisht rreth 7 për qind interes për kreditë, ndërsa për kategori të caktuara normat arrijnë deri në 7.8 për qind.

Për prodhuesit, megjithatë, sfidë nuk është vetëm interesi, por edhe koha që u nevojitet investimeve për të gjeneruar të ardhura. "Banka Zhvillimore duhet të ketë norma të ulëta të interesit, periudha afatgjata të kthimit dhe periudha 'grejs'", thotë Kuçi.

Periudha 'grejs' është një afat lehtësues gjatë të cilit huamarrësi mund të mos paguajë shumën bazë të kredisë, sipas kushteve të marrëveshjes.

Pse nevojitet një bankë tjetër?

Banka Zhvillimore nuk do të ishte mekanizmi i parë për lehtësimin e financimit të bizneseve në Kosovë.

Tashmë funksionon Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, i cili u ndihmon ndërmarrjeve të marrin kredi duke garantuar një pjesë të rrezikut për bankat.

Sipas një vlerësimi të Bankës Botërore, deri në shkurt të vitit 2026, Fondi kishte mbështetur me garanci mbi 20 mijë kredi, me vlerë të përgjithshme mbi një miliard euro, nga të cilat kishin përfituar afro 13 mijë ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme.

Garancitë kanë ndihmuar veçanërisht bizneset që nuk kanë kolateral të mjaftueshëm ose histori kreditore.

Megjithatë, Banka Botërore vëren se mungesa e monitorimit sistematik e bën të vështirë të vlerësohet nëse ky financim ka ndikuar në krijimin e vendeve të reja të punës.

Në korrik, Fondi njoftoi edhe për zgjerimin e një programi garancish, të mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe banka gjermane për zhvillim, KfW, për lehtësimin e kreditimit të ndërmarrjeve.

Ndryshe nga fondet e garancisë, të cilat mbështesin kreditë e institucioneve financiare ekzistuese, një bankë zhvillimore mund të financojë drejtpërdrejt investime afatgjata dhe sektorë që nuk marrin financim të mjaftueshëm nga tregu.

Por, ende nuk është e qartë se cilat nevoja të pambuluara do t'i adresonte Banka Zhvillimore e Kosovës dhe si do të bashkëpunonte me mekanizmat ekzistues.

Nga premtimi te projektligji

Ideja e Bankës Zhvillimore është pjesë e programit ekonomik të Lëvizjes Vetëvendosje prej vitesh.
Në shkurt të vitit 2021, para ardhjes në pushtet me mandat të plotë, kryetari i saj, Albin Kurti, kishte folur për kredi me interesa nën 3 për qind dhe periudha më të gjata lehtësuese për kthimin e tyre.
Më shumë se pesë vjet pas kësaj deklarate, institucioni ende nuk është themeluar.
Në mars të këtij viti, Ministria e Financave njoftoi nënshkrimin e marrëveshjeve me Bankën Botërore, në vlerë të përgjithshme prej rreth 96 milionë eurosh, për forcimin e sektorit financiar dhe lehtësimin e tregtisë.
Njëra marrëveshje, në vlerë prej rreth 50 milionë eurosh, përfshin mbështetjen për themelimin e Bankës Zhvillimore, krahas forcimit të institucioneve ekzistuese financiare, zgjerimit të garancive kreditore dhe zhvillimit të infrastrukturës së pagesave.
Banka Botërore e miratoi financimin e projektit në janar të vitit 2025, por ende nuk dihet se sa mjete do të ndahen konkretisht për bankën e re.
Në qershor, ministri i Financave i Kosovës, Hekuran Murati, formoi një grup punues për hartimin e projektligjit për Bankën Zhvillimore.
Sipas programit të Qeverisë, projektligji pritet t'i dërgohet Kuvendit në maj të vitit 2027 - më shumë se gjashtë vjet pas premtimit fillestar të Vetëvendosjes.
Ministria e Financave nuk dha informacione për përbërjen e grupit punues dhe ecurinë e hartimit të projektligjit.
Nuk është bërë i ditur as afati kur banka mund të fillojë dhënien e kredive.

Çfarë premton Qeveria?

Qeveria e ka paraqitur Bankën Zhvillimore si një instrument për nxitjen e prodhimit vendor, investimeve dhe eksporteve. "Prodhimi është themeli i zhvillimit tonë ekonomik", tha kryeministri Albin Kurti gjatë prezantimit të programit të ri qeveritar në Kuvend, më 13 shtator.
Sipas tij, bizneset që investojnë në prodhim dhe krijojnë vende pune, do të kenë qasje më të lehtë në kredi dhe kosto më të ulët financimi.
Po sipas tij, Banka Zhvillimore do të financojë drejtpërdrejt projekte strategjike, do të mbështesë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme përmes bankave dhe do t'u ofrojë prodhuesve e eksportuesve garanci për pagesa.
Megjithatë, hollësitë e funksionimit të saj - përfshirë kapitalin fillestar, kriteret për përfituesit dhe normat e interesit që do t'i ofrojë - nuk janë bërë ende të ditura.

Kush do ta paguajë koston e kredive më të lira?

Një tjetër çështje e pazgjidhur është mënyra e financimit të bankës dhe rreziku që mund të marrë përsipër shteti.
Bankat zhvillimore mund të financohen nga buxheti publik, institucionet financiare ndërkombëtare apo burime të tjera, varësisht nga modeli i tyre.
Por, kreditë me interesa më të ulëta nuk janë pa kosto.
Nëse banka financon projekte me kushte më të favorshme ose merr përsipër rreziqe më të larta, duhet të përcaktohet kush do t'i mbulojë kostot dhe humbjet e mundshme.
Në rastin e Kosovës, ende nuk dihet sa kapital do të investojë shteti, nëse do të ketë subvencione nga buxheti dhe kush do t'i përballojë humbjet nga kreditë që nuk kthehen.

Interesa më të ulëta, por edhe rrezik politik

Mejdi Bektashi, profesor në Fakultetin Ekonomik dhe ish-anëtar i Bordit të BQK-së, thotë se Banka Zhvillimore duhet të përqendrohet në financimin e investimeve, veçanërisht në industrinë prodhuese, dhe jo në pranimin e depozitave nga qytetarët.
Sipas tij, kjo do të mund të nxiste prodhimin vendor dhe të ndikonte në uljen e deficitit tregtar. "Kjo bankë mund të ndikojë në uljen e normave të interesit në bankat tjera komerciale, duke rritur ofertën e kredive afatgjata", thotë ai për Radion Evropa e Lirë.
Por, Bektashi paralajmëron se rezultatet do të varen nga menaxhimi profesional, transparenca dhe shmangia e ndërhyrjeve politike.
Rezerva shpreh edhe Edison Jakurti, ligjërues i ekonomisë në Abilene Christian University, në Teksas të Shteteve të Bashkuara.
Ai vlerëson se banka mund të ndihmojë industrinë prodhuese, por dyshon në aftësinë e institucioneve për ta menaxhuar në mënyrë të pavarur dhe efikase.
"Mjafton të shohim ngecjen disavjeçare të Fondit Sovran dhe mungesën e përmirësimeve thelbësore në performancën e



ndërmarrjeve publike. Në këto rrethana, është vështirë të pritet që themelimi i një institucioni tjetër, në vetvete, të sjellë rezultate të ndryshme", thotë Jakurti për Radion Evropa e Lirë.
Ligji për Fondin Sovran - një mekanizëm i propozuar nga Qeveria për menaxhimin e pasurive shtetërore - u miratua në dhjetor të vitit 2023, por u dërgua për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Partia Demokratike e Kosovës, të cilat pretenduan se binte ndesh me parimet e ekonomisë së lirë të tregut.
Në raportin e vitit 2025 për Kosovën, Komisioni Evropian konstatoi se krijimi i Fondit Sovran ishte vonuar për shkak të shqyrtimit kushtetues.
Jakurti vlerëson se përplasjet politike rreth projekteve të tilla kanë penguar zbatimin e politikave publike dhe se krijimi i institucioneve të reja nuk garanton rezultate pa përmirësuar funksionimin dhe pavarësinë e tyre.

BQK-ja: Banka e re nuk duhet ta cenojë konkurrencën

Në Kosovë operojnë dhjetë banka komerciale, të cilat licencohen dhe mbikëqyren nga BQK-ja.
Por, modeli i licencimit dhe mbikëqyrjes së Bankës Zhvillimore ende nuk është përcaktuar.
Në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë, BQK-ja konfirmon se ka marrë pjesë në konsultimet paraprake për rolin dhe arkitekturën financiare të bankës, në kuadër të projektit me Bankën Botërore.
Sipas saj, modeli përfundimtar juridik, institucional dhe operacional, përfshirë licencimin dhe mbikëqyrjen, duhet të përcaktohet me ligj.
BQK-ja thekson se banka e re duhet të adresojë nevojat e pambuluara për financim, "pa cenuar konkurrencën në sektorin financiar dhe duke respektuar parimet e financimit të qëndrueshëm".
Kjo do të kërkojë një model që mundëson financim më të favorshëm për sektorë të caktuar, pa krijuar konkurrencë të pabarabartë me bankat komerciale.

Çfarë tregojnë përvojat e rajonit?

Maqedonia e Veriut ka një bankë zhvillimore që nga viti 1998, e cila mbështet ndërmarrjet, eksportet dhe investimet përmes kredive dhe garancive.
Në një program të mbështetur nga Qeveria, bizneset mund të përfitojnë kredi me interes vjetor prej 1.95 për qind, afat kthimi deri në 15 vjet dhe periudhë 'grejs' deri në tre vjet. Kreditë shpërndahen përmes bankave komerciale.
Sipas Ministrisë së Financave të Maqedonisë së Veriut, deri në janar të këtij viti ishin vënë në dispozicion mbi 224 milionë euro për mbështetjen e investimeve të bizneseve.
Ndërkaq, sipas një vlerësimi të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), banka kishte menaxhuar linja kreditore prej 62 milionë eurosh gjatë vitit 2024, për financimin e 278 projekteve.
Megjithatë, OECD-ja vëren se, pavarësisht monitorimit të aktiviteteve të bankës, nuk janë kryer vlerësime të ndikimit të programeve të saj në përmirësimin e qasjes së bizneseve në financim.
Edhe Shqipëria ka ndërmarrë hapa për krijimin e një banke zhvillimore. Ligji për themelimin e saj u miratua në mars të vitit 2025, ndërsa në dhjetor banka u regjistrua si shoqëri aksionare.
Me kapital fillestar të paraparë prej dhjetë miliardë lekësh, apo mbi 100 milionë euro, ajo synon të mbështesë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, eksportet dhe projektet infrastrukturore.

A mund ta ndryshojë banka ekonominë e Kosovës?

Nevoja për të mbështetur prodhimin vendor pasqyrohet edhe në bilancin tregtar të Kosovës.
Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, vitin e kaluar importet tejkaluan shtatë miliardë euro, ndërsa eksportet e mallrave arritën në rreth një miliard euro.
Një bankë zhvillimore mund t'u krijojë bizneseve mundësi për të investuar në makineri, teknologji dhe kapacitete të reja prodhuese.
Por, financimi më i lirë nuk i zgjidh vetvetiu pengesat e prodhimit, përfshirë kostot e operimit, mungesën e fuqisë së kualifikuar punëtore dhe konkurrencën në tregjet ndërkombëtare.
Mbetet gjithashtu e paqartë nëse banka do të financojë investime që bizneset nuk arrijnë t'i realizojnë përmes bankave komerciale dhe mekanizmave ekzistues.
Për prodhues si Shpejtim Kuçi, kreditë afatgjata dhe me interesa më të ulëta do të krijonin më shumë mundësi për zgjerim. "… dhe, rrjedhimisht, rritje të fuqisë punëtore", përfundon ai.

Diplomon gjenerata e 63-të e Policisë së Kosovës

Prishtinë, 6 nëntor - Është mbajtur ceremonia e diplomimit të gjeneratës së 63-të të Policisë së Kosovës, në të cilën kanë diplomuar gati 400 kadetë të rinj.Në mesin e tyre janë edhe Jetlum Bunjaku dhe Sokol Zymeri, djemtë e heronjve Afrim Bunjaku dhe Enver Zymeri, të cilët ranë në krye të detyrës. Në këtë ceremoni kanë marrë pjesë kryeministri Albin Kurti, kryeparlamentarja Albulena Haxhiu, ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, komandanti i FSK-së, Bashkim Jashari, kryeprokurori Zejnulla Gashi, drejtori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), Petrit Ajeti, si dhe përfaqësues të tjerë institucionalë. Ceremonia e diplomimit ishte paraparë të mbahej më 30 tetor, por ishte shtyrë për shkak të mungesës së uniformave për policët e rinj.



Ministri Vitia viziton foshnjën e parë të lindur përmes IVF-së në QKUK



PRISHTINË, 6 NËNTOR - Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) ka lindur foshnja e parë nga një shtatzëni e realizuar përmes shërbimit të fertilizimit të asistuar mjekësor.

Lajmin e ka bërë me dije ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, i cili ka njoftuar se sot ka vizituar nënën dhe vajzën e saj, duke e cilësuar këtë si një arritje të rëndësishme për shëndetësinë në Kosovë.

Vitia ka theksuar se kjo përbën një mundësi dhe shpresë të re për të gjithë ata që dëshirojnë ta realizojnë ëndrrën e prindërimit.

Ai gjithashtu ka uruar nënën për lindjen e vajzës, duke i dëshiruar vogëlushes jetë të gjatë dhe të shëndetshme.

Ministri e ka falënderuar edhe stafin e Klinikës së Gjinekologjisë për angazhimin, profesionalizmin dhe kujdesin ndaj pacientëve.

ZRRE DISKUTON PËR NDRYSHIMET NË RREGULLOREN PËR VETËKONSUMATORËT E ENERGJISË SË RIPËRTËRISHME



PRISHTINË, 6 NËNTOR - Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka mbajtur konsultim me palët e interesit lidhur me Koncept-Dokumentin për përditësimin e Rregullës për Vetë-Konsumatorët me Burime të Ripërtërishme të Energjisë.

Konsultimi është mbajtur më 5 nëntor 2026, me qëllim të avancimit të kornizës rregullative dhe përafrimit të saj me kërkesat e Ligjit për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë.

Gjatë takimit janë paraqitur propozimet kryesore të dokumentit, përfshirë ruajtjen e pragjeve aktuale të kapacitetit, përcaktimin e kapacitetit në përputhje me mundësitë teknike të rrjetit, si dhe trajtimin e energjisë së tepërt të injektuar në rrjet bazuar në çmimin e tregut një ditë para të ALPEX-it.

Një tjetër propozim është zgjatja e periudhës së shfrytëzimit të kredisë monetare deri në një vit kalendarik. Dokumenti parasheh gjithashtu mekanizma për rikuperimin e kostove të rrjetit, procedura të shkallëzuara të regjistrimit, rregulla për vetë-konsumatorët që veprojnë bashkërisht dhe masa mbrojtëse për sistemet e ruajtjes së energjisë.

ZRRE ka theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes së të gjithë aktorëve relevantë në këtë proces, duke vlerësuar se konsultimi publik dhe dialogu profesional janë thelbësorë për përmirësimin e kornizës rregullative dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.

Për përgatitjen e Koncept-Dokumentit, ZRRE ka pasur mbështetjen e konsulentëve të Optima Energy Consulting dhe financimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh).

Aktualisht, procesi ndodhet në fazën e konsultimit me palët e interesit. Komentet dhe rekomandimet e pranuara do të shqyrtohen gjatë finalizimit të dokumentit dhe hartimit të Rregullës së amendamentuar.

Pas kësaj, drafti i ri i Rregullës do t'i nënshtrohet edhe një konsultimi tjetër publik përpara finalizimit dhe miratimit të tij.

MBI 31 MIJË VAKSINA KUNDËR GRIPIT SEZONAL JANË ADMINISTRUAR NË KOSOVË



PRISHTINË, 6 NËNTOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se deri më 6 nëntor 2026 në Kosovë janë administruar gjithsej 31 mijë e 400 doza të vaksinës kundër gripit sezonal. Sipas IKShPK-së, vaksinat janë administruar në periudhën nga 21 tetori deri më 6 nëntor, duke e vlerësuar këtë si tregues të angazhimit të institucioneve shëndetësore dhe vetëdijesimit të qytetarëve për rëndësinë e vaksinimit.

IKShPK u ka bërë thirrje qytetarëve të vaksinohen me kohë, veçanërisht personave që bëjnë pjesë në grupet me rrezik të lartë për komplikime nga gripi.

Në mesin e grupeve për të cilat rekomandohet veçanërisht vaksinimi janë personat mbi moshën 65-vjeçare, ata me sëmundje kronike, gratë shtatzëna, fëmijët, personat me imunitet të dobësuar dhe punëtorët shëndetësorë.

Vaksinimi rekomandohet edhe për personat që për shkak të profesionit apo rrethanave të tjera janë më të ekspozuar ndaj infeksioneve respiratore.

Instituti rikujton se vaksina është masa më e rëndësishme parandaluese për uljen e rrezikut nga gripi sezonal dhe komplikimet e tij. Mbrojtja nga vaksina zhvillohet rreth dy javë pas administrimit të saj.

Meqenëse aktiviteti i gripit sezonal pritet të rritet gjatë muajve të ardhshëm, IKShPK u bënë thirrje qytetarëve që të vaksinohen në institucionet e kujdesit parësor shëndetësor, përkatësisht në QKMF, QMF dhe AMF në komunat e tyre.

Kosova dhe Shqipëria stërviten bashkë në Prevallë për Kërkim-Shpëtim Malor



PRISHTINË, 6 NËNTOR - Ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Ermal Nufi, ka bërë me dije se është zhvilluar një stërvitje e përbashkët në Kërkim-Shpëtimin Malor ndërmjet efektivëve të Bazës së Mbështetjes dhe Emergjencave Civile - BMEC të Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Stërvitja, sipas Nufit, është zhvilluar mes datave 2-5 nëntor 2026 në Prevallë të Prizren, e cila "shërbeu për shkëmbimin e përvojave, testimin e pajisjeve të reja dhe praktikimin e teknikave të kërkim-shpëtimit, përfshirë evakuimin e një personi të dëmtuar në terren malor".

"Një aktivitet që forcon bashkëpunimin në shërbim të jetës, si dhe kontribuon në forcimin e kapaciteteve profesionale, rritjen e ndërveprueshmërisë dhe konsolidimin e bashkëpunimit ndërmjet dy strukturave", shkroi Nufiu në "Facebook".

Kosova nis përgatitjet për fondet e reja të BE-së për periudhën 2028-2034



PRISHTINË, 6 NËNTOR - Në Kosovë është zhvilluar takimi koordinues për Kornizën e ardhshme Financiare Shumëvjeçare të Bashkimit Evropian (MFF) për periudhën 2028 - 2034, ku morën pjesë përfaqësues të BE-së dhe drejtorë të departamenteve përgjegjëse për procesin e anëtarësimit në institucionet e Qeverisë së Kosovës.

Në fokus të takimit ishte përgatitja për instrumentet e reja financiare të BE-së, përcaktimi i prioriteteve kombëtare, si dhe planifikimi i reformave dhe investimeve për periudhën e ardhshme.

Gjatë diskutimeve u theksua rëndësia e forcimit të kapaciteteve institucionale për menaxhimin dhe zbatimin e fondeve evropiane, veçanërisht pas vlerësimit pozitiv të Komisionit Evropian në Raportin për Kosovën 2026, sa i përket planifikimit dhe monitorimit të mbështetjes financiare të BE-së.

Po ashtu, u vlerësua se koordinimi ndërinstitucional dhe përgatitjet e hershme janë thelbësore që Kosova t'i shfrytëzojë sa më mirë mundësitë që ofron korniza e re financiare, duke i harmonizuar prioritetet zhvillimore të vendit me reformat që lidhen me procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

IKD-ja KËRKON PËRGJEGJËSI PENALE PËR MOSZBATIMIN E AKTGJYKIMEVE TË KUSHTETUESES, OPOZITA BËN THIRRJE PËR RESPEKTIMIN E TYRE



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Moszbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe mungesa e mekanizmave efektivë për të siguruar zbatimin e tyre janë diskutuar në tryezën e organizuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), ku përfaqësues të partive politike dhe shoqërisë civile kanë ngritur shqetësime për cenimin e autoritetit të gjykatës dhe pasojat që kjo praktikë ka për funksionimin e shtetit të së drejtës. Gjatë diskutimit është theksuar se vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk mund të mbeten vetëm në letër, por duhet të zbatohen nga të gjitha institucionet, ndërsa është kërkuar edhe plotësimi i Kodit Penal për ta përcaktuar shprehimisht përgjegjësinë penale në rastet e moszbatimit të tyre.

Hulumtuesi i lartë në IKD, Naim Jakaj, ka thënë se moszbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është problem që shkon përtej rasteve individuale, duke cenuar autoritetin e këtij institucioni dhe të drejtat e qytetarëve. "Në rastin KO79/23, për Ligjin për Pagat, Kuvendi nuk e përmbushi brenda afatit detyrimin për të ndryshuar dispozitën për shtesën e përvojës së punës. Ndërsa, në rastin KO124/25, për konstituimin e Kuvendit, Gjykata Kushtetuese konstatoi në gusht të vitit 2025 se deputetët nuk e kishin zbatuar aktgjykimin e saj të mëparshëm. Pra, nga këto raste shohim se problemi është shumë më i gjerë. Moszbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nuk cenon vetëm autoritetin e saj, por prek drejtpërdrejt të drejtat e qytetarëve dhe dobëson besimin e tyre në institucionet e shtetit. Çfarë vlere ka një vendim në favor të një qytetari, nëse ai duhet të presë edhe dhjetë vjet për ta realizuar të drejtën e tij? Dhe çfarë kuptimi ka që Kushtetuta i bën vendimet të detyrueshme, nëse institucionet nuk i zbatojnë ato? Këto janë pyetje që dalin nga rastet e trajtuara në analizën tonë. Një tjetër problem që kemi evidentuar lidhet me Kodin Penal. Aktualisht, neni 394 e parasheh përgjegjësinë penale për mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Mirëpo, në këtë nen nuk përmenden shprehimisht vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Kjo krijon paqartësi, sepse Gjykata Kushtetuese nuk është pjesë e sistemit të gjykatave të rregullta. Ne kemi parë edhe se si e kanë rregulluar këtë çështje shtetet e tjera", ka thënë Jakaj.

Ai ka bërë me dije se nisma legjislative është mbështetur nga mbi 12 mijë qytetarë dhe tashmë i është dorëzuar Kuvendit të Kosovës, duke kërkuar që deputetët ta trajtojnë me seriozitet.

Ushtruesja e detyrës së kryetares së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka thënë se obligimi për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i përcaktuar qartë me Kushtetutë dhe se institucionet duhet ta respektojnë atë, pavarësisht dallimeve politike. Ajo ka theksuar se respektimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese duhet të jetë standard i njëjtë për të gjitha partitë politike, përfshirë edhe PDK-në, duke përmendur rastet kur janë kontestuar ligje të miratuara nga shumica parlamentare.

Ndërkaq, deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Armend Zemaj, ka thënë se respektimi i Kushtetutës dhe vendimeve që burojnë prej saj duhet të jetë parim themelor i funksionimit të shtetit demokratik.

Ai ka rikujtuar se ndërtimi institucional i Kosovës është mbështetur në akte kushtetuese dhe politike, të cilat kanë shërbyer si bazë për organizimin dhe funksionimin e shtetit. Sipas tij, vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk mund të trajtohen si rekomandime politike, ndërsa problematike mbetet edhe mungesa e dispozitave të qarta në Kodin Penal për trajtimin e moszbatimit të këtyre vendimeve.

Deputeti i Aleancës, Burim Ramadani, ka vlerësuar se moszbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është shndërruar në një praktikë shqetësuese, e cila po ndikon edhe në respektimin e të drejtave civile dhe qytetare në Kosovë. Ai ka thënë se problemi nuk kufizohet vetëm në moszbatimin e aktgjykimeve kushtetuese, por shfaqet edhe në raste të tjera të shkeljes së të drejtave të qytetarëve.

Gërvalla në Forumin BE - Ballkani Perëndimor: Korrupsioni kërkon luftë pa kompromis



PRISHTINË, 6 NËNTOR - Ministrja e Drejtësisë, Donika Gërvalla, ka theksuar nevojën për luftë të pakompromis kundër korrupsionit, duke kërkuar verifikimin e pasurisë së pajustifikueshme, konfiskimin e përfitimeve të paligjshme dhe përgjegjësi për zyrtarët publikë. Këto deklarata Gërvalla i bëri në margjinat e Forumit Ministror BE - Ballkani Perëndimor për Drejtësi dhe Punë të Brendshme, në panelin kushtuar luftës kundër korrupsionit. Ajo tha se përballja me këtë dukuri kërkon vullnet të palëkundur institucional, sistem të pavarur dhe profesional të drejtësisë, zbatim të pakompromis të ligjit dhe bashkëpunim të qëndrueshëm ndërkombëtar. Sipas saj, asnjë pozitë publike, pasuri apo lidhje politike nuk duhet të shërbejë si mburojë përballë ligjit.

Gërvalla ka theksuar se Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar në thellimin e reformave në drejtësi, forcimin e mekanizmave për parandalimin dhe ndëshkimin e korrupsionit, si dhe zgjerimin e bashkëpunimit me partnerët evropianë. Ajo ka shtuar se qëllimi është forcimi i sundimit të ligjit dhe garantimi i përgjegjësisë dhe barazisë së të gjithë qytetarëve para ligjit.

BQK-ja zgjeron bashkëpunimin me Bankën e Italisë edhe në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve financiarë

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Zëvendësguvernatorja e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Nesrin Shileku-Shala, së bashku me drejtoreshën e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit, Suzan Dervari, morën pjesë në Konferencën e 13-të për Mbrojtjen e Konsumatorit (13th Joint ESAs Consumer Protection Day), të organizuar nga tri Autoritetet Evropiane Mbikëqyrëse (EBA, EIOPA dhe ESMA), në bashkëpunim me Bankën e Italisë, më 4 nëntor 2026, në Romë.

Konferenca trajtoi zhvillimet dhe sfidat në mbrojtjen e konsumatorëve financiarë, me fokus në qasjen e drejtë në shërbimet financiare, qeverisjen e produkteve financiare dhe ndikimin e inteligjencës artificiale në këtë fushë.

Gjatë konferencës delegacioni i BQK-së shkëmbeu pikëpamje edhe me Magda Bianco, drejtoreshë e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Edukimin Financiar në Bankën e Italisë, e cila ishte një nga panelistet e konferencës.

Në vijim të pjesëmarrjes në konferencë, zëvendës-guvernatorja Shileku-Shala dhe Dervari zhvilluan një takim bilateral në Bankën e Italisë me zëvendësguvernatoren, Chiara Scotti, si dhe me përfaqësuesit përgjegjës për mbrojtjen e konsumatorëve financiarë në këtë institucion.

Gjatë takimit u diskutuan zhvillimet dhe praktikat në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve financiarë, me fokus në transparencën e shërbimeve financiare, trajtimin e ankesave dhe mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve të shërbimeve financiare.

Gjithashtu, u diskutuan mundësitë për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, me fokus në njohjen me përvojat dhe praktikat e Bankës së Italisë në këtë fushë.



Pjesëmarrja në konferencë dhe takimi bilateral me Bankën e Italisë pasqyrojnë angazhimin e vazhdueshëm të BQK-së për avancimin e mbrojtjes së konsumatorëve financiarë, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe zgjerimin e bashkëpunimit me autoritetet homologe evropiane.

BQK mbetet e përkushtuar ndaj përmirësimit të kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse për mbrojtjen e konsumatorëve financiarë dhe përafrimit të saj me standardet dhe praktikat më të mira evropiane.

SPANCA: REKOMANDIMET E AUDITIMIT ENDE NUK PO MARRIN VËMENDJEN NGA NJË PJESË E INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Auditorja e përgjithshme Vlora Spanca ka paraqitur para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2025, i cili përmban rezultatet kryesore të punës audituese duke përfshirë opinionin, gjetjet si dhe rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Raporti është rezultat i auditimit të Raportit Vjetor Financiar të Qeverisë për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 dhe i 131 raporteve individuale të auditimit të organizatave buxhetore, ndërmarrjeve publike, projekteve dhe auditimeve të performancës.

Ajo ka theksuar se në tërësi rezultatet tregojnë se ka pasur përmirësime në disa fusha, por vazhdojnë të jenë të pranishme mangësi që kërkojnë ndërhyrje dhe përgjegjësi më të madhe institucionale. "Nga auditimi i Raportit Vjetor Financiar të Qeverisë për vitin 2025, kemi vlerësuar se cilësia e raportimit financiar ka shënuar përmirësime ndër vite dhe se raportimi është në përputhje me standardet dhe kornizën ligjore përkatëse në aspektet e vlerësuara. Megjithatë, në bazë të rezultateve të auditimit, Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë opinion të kualifikuar. Ky opinion nënkupton se, përveç ndikimit të çështjeve të paraqitura në bazën për opinionin e kualifikuar, Raporti Vjetor Financiar paraqet një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën përkatëse të raportimit financiar. Çështjet



kryesore që kanë ndikuar në këtë opinion lidhen me klasifikimin jo të duhur të shpenzimeve, pasuritë, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet e raportuara", ka deklaruar Spanca.

Ajo ka treguar se gjatë vitit 2025 Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë gjithsej 1 032 rekomandime për përmirësimin e menaxhimit të financave publike dhe funksionimit të institucioneve. "Megjithatë, nga rekomandimet e dhëna në vitin 2024, janë zbatuar vetëm 36 %. Ky nivel i zbatimit tregon se rekomandimet e auditimit ende nuk po marrin vëmendjen dhe veprimin e nevojshëm nga një pjesë e institucioneve përgjegjëse. Kur rekomandimet nuk zbatohen, mangësitë vazhdojnë të përsëriten, rreziqet mbeten të pranishme dhe mundësia për të përmirësuar menaxhimin e parasë publike kufizohet. Në këtë proces, Kuvendi ka një rol të rëndësishëm përmes shqyrtimit sistematik të raporteve të auditimit, kërkimit të llogarisë nga institucionet përgjegjëse dhe përcjelljes së masave konkrete për adresimin e gjetjeve", ka thënë Spanca.

MINTI DHE "TERMOKOS"-I BASHKËRENDOJNË VEPRIMET PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË KONSUMATORËVE DHE VERIFIKIMIN E MATËSVE TË ENERGJISË TERMIKE

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Në kuadër të bashkëpunimit dhe bashkërendimit institucional për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve, zyrtarë të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI) kanë zhvilluar një takim të përbashkët me përfaqësuesit udhëheqës të ndërmarrjes publike "Termokos".

Gjatë këtij takimi drejtoresha e Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës (AMK), Sebahate Bushrani, së bashku me këshilltarin e kabinetit të ministres, Ali Tafarshiku, kanë theksuar rëndësinë e zbatimit të Ligjit për Metrologjinë dhe të rregulloreve përkatëse për mjetet matëse, me theks të veçantë në verifikimin periodik të matësve të energjisë termike, në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore.

Nga ana e përfaqësuesve të "Termokos"-it, drejtori i Furnizimit, Kastriot Blaca, ka



paraqitur projektin që është duke u implementuar përmes fondeve të Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC), i cili parasheh vendosjen e matësve të energjisë termike për të gjithë konsumatorët e ngrohjes në kryeqytet.

Sipas informatave të paraqitura, projekti pritet të përfundojë në gjysmën e vitit 2027.

Pas përfundimit të tij, AMK-ja do t'i sigurojë të dhënat për të gjithë matësit e instaluar dhe në përputhje me afatet dhe kërkesat ligjore, do t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme për verifikimin e tyre në laboratorë profesionalë të autorizuar.

Ky takim është pjesë e angazhimeve të vazhdueshme për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe sigurimin e zbatimit të legjislacionit në fushën e metrologjisë.

Kontrolli dhe verifikimi ligjor i mjeteve matëse janë thelbësore për garantimin e saktësisë së matjeve, faturimit të drejtë të konsumatorëve dhe parandalimin e praktikave të padrejta ndaj tyre.

IQMT-ja vazhdon inspektimet ndaj bizneseve online dhe mbikëqyrjen e produkteve në transport drejt konsumatorëve

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut (IQMT) po vazhdon aktivitetet inspektuese ndaj bizneseve që operojnë online, me fokus të veçantë në mbikëqyrjen e produkteve që janë në transport drejt konsumatorëve.

Ekipet e IQMT-së, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) dhe Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), po realizojnë inspektime të shërbimeve postare në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Përmes 10 ekipeve inspektuese janë realizuar mbi 24 inspektime.

Gjatë këtyre kontrolleve janë evidentuar raste kur produktet nuk kishin kupon fiskal si dhe raste të tjera kur mungonte deklaracioni i prejardhjes së produktit dhe dokumentacioni përcjellës.

Në përputhje me ligjin për IQMT-në, inspektorët u kanë dhënë afat subjekteve përkatëse ta prezantojnë dokumentacionin e nevojshëm, në të kundërtën, do të ndërmerren masat përkatëse ligjore, përfshirë sekuestrimin e produkteve dhe shqiptimin e masave ndëshkuese.

Ky aksion mbikëqyrës përfshin gjithashtu inspektimin e faqeve online të bizneseve, reklamave të produkteve si dhe trajtimin e ankesave të paraqitura nga konsumatorët.

Përveç tetë komunave kryesore të vendit, aktivitetet inspektuese janë shtrirë edhe në komunat e tjera të rajonit të Dukagjinit, përkatësisht në Klinë, Istog, Deçan, Junik, Rahovec, Malishevë, Suharekë dhe Dragash.

IQMT mbetet i përkushtuar për forcimin e mbikëqyrjes së tregut, mbrojtjen e konsumatorëve dhe garantimin e konkurrencës së



drejtë, duke siguruar që çdo produkt që tregtohet në Republikën e Kosovës të jetë në përputhje me kërkesat ligjore.

ANATOMIA E NJË HUMBJEJE: NGA ICE TE EPSTEIN DHE IRANI, TË GJITHA GABIMET E PRESIDENTIT TRUMP

E nisi mandatin e dytë me mbështetje të fortë popullore, por e shpërdoroi atë deri në atë pikë sa të konsiderohej antiamerikan. Gabimet e presidentit Trump



Një fillim premtues dhe ëndrra për të hyrë në histori

Ishte mesi i shkurtit 2025, viti i parë i mandatit të dytë të Donald Trumpit, kur këshilltarët ekonomikë të Shtëpisë së Bardhë e vizituan presidentin për t'i përcjellë lajme të shkëlqyera: të ardhurat e familjeve amerikane po rriteshin, fondet e pensioneve po mbusheshin me para dhe Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) po rritej përtej parashikimeve.
Ndërkohë, demokratët ishin në rrëmujë të plotë dhe nuk dinin nga t'ia mbanin.
"Shumë gjëra të mira", kishte komentuar presidenti, duke shijuar paraprakisht idenë e vendit që fati po i përgatiste në histori.
Ndoshta pikërisht për këtë arsye, disa javë më vonë, ai kishte urdhëruar bombardimin e Iranit. Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu e kishte bindur se, duke eliminuar menjëherë ajatollah Khamenein, do të arrinte të mposhtte brenda pak ditësh armikun që prej gjysmë shekulli e quante Amerikën "Satani i Madh". Në këtë mënyrë, Trumpi mendonte se do të mund të vendosej në të njëjtin nivel historik me Franklin D. Rooseveltin gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Por gjërat nuk shkuan kështu.

Ai vendim fatal do të vinte në lëvizje një zinxhir gabimesh katastrofike, të shkaktuara pjesërisht nga mendjemadhësia dhe pjesërisht nga paaftësia, duke i hapur rrugën refuzimit të madh elektoral të së martës.
Kjo është historia e vrapimit të çmendur të Donald Trumpit drejt katastrofës, e rindërtuar ditë pas dite dhe çështje pas çështjeje nga New York Times, Wall Street Journal, Washington Post dhe agjencia Associated Press (AP).

Tarifat doganore dhe rikthimi i inflacionit. Gabimet e para të presidentit Trump

Trumpi ishte rikthyer në Shtëpinë e Bardhë me një mandat të fortë politik.
Çështja e parë ku kishte investuar kapitalin e tij politik, në prill, ishin tarifat doganore. Ai ishte i bindur se, përmes tyre, do t'u jepte një mësim evropianëve dhe do të siguronte të ardhura të mjaftueshme për ta bërë të panevojshëm sistemin e mbledhjes së taksave nga Shërbimi Amerikan i të Ardhurave të Brendshme (IRS), madje ndoshta deri në shfuqizimin e tij.
Ky ishte gabimi i parë madhor.
Gjykata e Lartë do t'i shpallte më vonë të paligjshme tarifat doganore, të cilat, sidoqoftë, nuk do të siguronin të ardhurat e parashikuara dhe as nuk do të ringjallnin industrinë prodhuese amerikane.
Përkundrazi, ato do të përgatisnin terrenin për rikthimin e fuqishëm të inflacionit.

Takimi me Putinin dhe premtimi i pambajtur për Ukrainën

Një tjetër moment kyç i vitit të parë ishte samiti i gushtit në Alaskë me Vladimir Putinin.
Trumpi vazhdonte ta konsideronte presidentin rus një mik, ndryshe nga presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky, të cilin e shihte si një figurë bezdisëse dhe që e kishte trajtuar keq gjatë takimit në Zyrën Ovale.
Gjatë fushatës elektorale, Donald Trumpi kishte premtuar se do t'i jepte fund luftës në Ukrainë brenda 24 orësh.
Me këtë premtim, ai kishte dëgjuar kërkesat e mbështetësve të lëvizjes MAGA (Make America Great Again), të cilët nuk donin të dëgjonin më për luftëra të pafundme, veçanërisht në Lindjen e Mesme. Por diçka nuk kishte funksionuar.
Ndoshta sepse Vladimir Putini nuk ishte ai miku gjenial dhe aq i respektuar që Trumpi kishte imagjinuar. Megjithatë, politika e jashtme nuk është faktori kryesor që përcakton votën e amerikanëve. Për më tepër, ata e vlerësonin përpjekjen e presidentit për të shpenzuar më pak para në Evropë.
Edhe goditja e parë ndaj programit bërthamor iranian, në qershor, ishte parë në këtë këndvështrim: arritja e rezultatit maksimal me përpjekjen minimale.

Vrasjet nga agjentët e ICE dhe tronditja e opinionit publik

Por shenjat e para të krisjes kishin ardhur më 7 janar, kur agjentët e Shërbimit të Imigracionit dhe Doganave (ICE) kishin qëlluar me armë Renee Good në rrugët e Minneapolisit, ku po kryenin operacione për arrestimin dhe dëbimin e emigrantëve pa dokumente.
Ajo ishte një grua që po protestonte duke ushtruar të drejtat e garantuara nga Kushtetuta amerikane. Njësoj si Alex Pretti, i cili u vra rreth dy javë më vonë. Melania Trump i kishte pëshpëritur të shoqit se Stephen Miller, arkitekti i politikës së dëbimeve masive, po e tepronte. Por Donald Trumpit iu desh kohë ta dëgjonte.
Vetëm më pas ai vendosi të largonte Greg Bovinon, zyrtarin e forcave të zbatimit të ligjit që autori e përshkruan si një vigjilent të veshur si pjesëtar i SS-ve naziste, si dhe Kristi Noem, të cilën e etiketon si vrasëse qensh me kapele kauboji.
Në këtë pikë, amerikanët filluan të pyesnin veten nëse administrata që mbante sloganin "America First" nuk ishte, në të vërtetë, antiamerikane.
A ishte ajo e gatshme të shkelte rregullat themelore të demokracisë liberale? Ndërkohë, votuesit me origjinë hispanike kishin filluar të pendoheshin që e kishin mbështetur Trumpin në zgjedhje.

Skandali Epstein dhe përçarja brenda lëvizjes MAGA

Ndoshta deri në atë moment mandati i Trumpit nuk ishte dëmtuar ende në mënyrë të pakthyeshme.
Megjithatë, administrimi i keq i çështjes Jeffrey Epstein kishte goditur edhe vetë botën MAGA, duke shkaktuar përçarje me figurat më të zemëruara dhe më radikale të kampit trumpist.
Mes tyre ishte edhe Marjorie Taylor Greene, mbështetëse fanatike e teorive konspirative të QAnon dhe dikur një nga besniket më të mëdha të presidentit.
Askush nuk do të mund ta zhdukë dyshimin se Trumpi, ndërsa peshonte avantazhet dhe rreziqet e një sulmi ndaj Iranit, kishte parasysh edhe shpresën për ta larguar nga vëmendja mediatike skandalin e miliarderit pedofil Epstein. Bëhej fjalë për një person të cilit Trumpi, sipas artikullit, i dërgonte vizatime pornografike në formën e kartolinave të urimit.
Sidoqoftë, presidenti kishte vendosur të vazhdonte me sulmin ndaj Iranit, duke premtuar se gjithçka do të zgjidhej brenda gjashtë javësh.

Lufta me Iranin: Gabimi që përshpejtoi katastrofën

Edhe këtë herë, gjërat nuk shkuan sipas parashikimeve. Lufta shkaktoi përplasje me aleatë të Shteteve të Bashkuara. Njëkohësisht, Trumpi u afrua tepër me kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu, një zgjedhje për të cilën më vonë do ta kritikonte edhe vetë zëvendëspresidenti JD Vance.
Kjo politikë shkaktoi gjithashtu një tjetër përçarje të dhimbshme me një ish-mbështetës të rëndësishëm të Trumpit, komentatorin konservator Tucker Carlson. Gjeneralët dhe strategët ushtarakë e kishin paralajmëruar presidentin për rrezikun e mbylljes së Ngushticës së Hormuzit, një nga rrugët më të rëndësishme të transportit botëror të naftës. Por Trumpi nuk i kishte dëgjuar.
Pasojat ishin shpërthimi i çmimeve të benzinës dhe rritja e përgjithshme e kostos së jetesës.

Pasurimi i familjes Trump dhe akuzat për korrupsion

Ndërsa amerikanët përballeshin me çmime gjithnjë e më të larta, ata shihnin presidentin dhe familjen e tij duke u pasuruar.
Mes çështjeve të diskutueshme ishte edhe ideja e shitjes paraprakisht të aksesit në mesazhet që Trumpi publikonte në rrjetet sociale, përmes të cilave ai ndikonte në lëvizjet e tregjeve financiare. Korrupsioni kishte filluar të shfaqej si një shqetësim i rëndësishëm në sondazhet e opinionit publik.
Megjithatë, gjatë Konventës së Dallasit, Trumpi kishte premtuar nga 5 mijë dollarë për çdo amerikan, me synimin për t'i nxitur të votonin kandidatët e tij, të cilët rezultuan zgjedhje të gabuara.

Zgjedhjet e mesmandatit: Referendumi që Trumpi e kërkoi vetë

Ndërsa popullariteti i presidentit vazhdonte të binte, këshilltarët i sugjeronin të mbante një profil të ulët dhe të shmangte daljet e tepërta publike. Por Trumpi bëri pikërisht të kundërtën. Ai i shndërroi zgjedhjet e mesmandatit në një referendum për veten e tij.
Në të njëjtën kohë, vazhdonte të mburrej me sallën madhështore të ballove që po ndërtohej në Shtëpinë e Bardhë.
Sjellja e tij i ngjante asaj të Marie Antoinette-s përpara Revolucionit Francez: një udhëheqës i shkëputur nga problemet e popullit, i përqendruar te luksi dhe madhështia personale, ndërsa pakënaqësia shoqërore rritej.

Revolucioni elektoral dhe rrëzimi politik i Trumpit

Dhe revolucioni ndodhi vërtet. Por këtë herë nuk bëhej fjalë për një revolucion të dhunshëm si ai francez. Ishte një revolucion elektoral, që u kthye kundër vetë Donald Trumpit. Dhe këtë herë, në kuptimin figurativ, ishte koka e tij politike ajo që përfundoi nën gijotinë. / La Repubblica

MILIARDA DOLLARË TË HEDHUR NË ERË: KUR PUSHTETI I PARASË MPOSHTET NGA FORCA E IDEALEVE

Elon Musk shpenzoi i vetëm 474 milionë dollarë për të mbështetur republikanët. Por nuk arriti të kuptonte se në politikë pushteti i parasë nuk sjell gjithçka dhe etika është rikthyer sërish si një vlerë vendimtare

474 milionë dollarët e Elon Musk nuk arritën të blinin fitoren

Me 474 milionë dollarët që Elon Musk hodhi në erë për të mbështetur kandidatët republikanë të mundur në zgjedhjet e mesmandatit, mund të bliheshin 77 milionë hamburgerë Big Mac, më shumë se një për çdo banor të Italisë, 13 mijë automjete Tesla Model 3 ose të paguhej paga e një senatori amerikan për 2.724 vjet.

Këtë përllogaritje e bën Charlie Walzer, gazetar i revistës The Atlantic.

Bilanci i shpenzimeve të pronarit të SpaceX është marramendës: 216 milionë dollarë të derdhur në fondin America PAC, 168 milionë në Senate Leadership Fund dhe 30 milionë për republikanët që kandidonin për Dhomën e Përfaqësuesve. Dhe në këtë llogari mungojnë ende transfertat përfundimtare, që e afrojnë shumën totale në gjysmë miliardi dollarë.

Megjithatë, për Musk këto janë thjesht para xhepi: vetëm një e njëzeta e një për qind e pasurisë së tij. Është sikur një person që fiton 50 mijë dollarë në vit t'i japë partisë së tij një bakshish prej 25 dollarësh.

Pushteti i parasë? Po pse dollarët nuk arritën të bindnin votuesit?

Mediat ia atribuojnë disfatën e Trumpit luftës me Iranin, inflacionit dhe neverisë së qytetarëve ndaj korrupsionit.

Por, përballë vërshimit të kotë të miliona dollarëve të Musk, një shpjegim origjinal vjen nga Jani, një 25-vjeçar me ngjyrë që punon si kamerier në Caucus Club, një vendtakim i njohur i politikanëve në Detroit.

Pikërisht aty, mes biftekëve dhe koktejeve Martini, në vitin 1961 debutoi në moshën 18-vjeçare Barbra Streisand, duke kënduar përpara magnatëve të industrisë automobilistike Henry Ford II dhe Lee Iacocca, si dhe kryebashkiakëve Young dhe Cavanagh.

Jani rrëfen: "Telefoni im nuk pushonte së rëni nga njoftimet me postime në mbështetje të kandidatit republikan Rogers dhe meme që paraqisnin demokratin El-Sayed me kefijen e terroristëve. Ishte një bombardim mesazhesh propagandistike, i paguar nga Musk. Kështu vendosa të merrja pushim paraditen dhe shkova të votoja. Gjyshi im më vinte të dëgjoja këngën e Beatles, Can't Buy Me Love – dashuria nuk blihet me para. Por, siç duket, as Kongresi nuk mund të blihet…".

Brezi i ri politik kundër pushtetit të miliarderëve

Edhe politikanët e sapozgjedhur janë të të njëjtit mendim. Nga Austini i Teksasit, seminaristi James Talarico predikon: "Nuk do të lejojmë që miliarderët të na nënshtrojnë".

Ndërsa nga Kansasi, pastori Hamilton paralajmëron: "Ne i kemi përmbysur tavolinat e tregtarëve në Tempull". Është një referencë e drejtpërdrejtë biblike, ku mesazhi i Ungjillit vihet përballë hipokrizisë së farisenjve.

Me një çiltërsi të pazakontë, Talarico i shndërron paratë e Musk në një objektiv politik. Tridhjetë monedhat e argjendta të tradhtisë biblike janë bërë tashmë gjysmë miliardi dollarë. Por parlamentarët nuk janë njerëz që mund të blihen për të ofruar shërbimet e tyre.

Sipas autorit, ndikimi i miliarderëve arrogantë, të lidhur me Afrikën e Jugut, si Elon Musk, Peter Thiel dhe David Sacks, synonte të krijonte një lloj aparteidi kulturor. Demokracia trajtohej si një mall me ulje çmimi në Amazon: mjaftonte një klikim dhe Uashingtoni përfundonte në shportën e blerjeve.

Jeff Bezos nuhat ndryshimin e erës politike

Ndryshe nga Musk, Jeff Bezos, më dinak në leximin e zhvillimeve politike, duket se është ndër të parët që ka kuptuar se era po ndryshon. Pasi ishte përulur përpara Trumpit si në një skenë të serialit Game of Thrones, pronari i Amazonit ka filluar të lirojë disi kontrollin mbi gazetën prestigjioze Washington Post. Që prej së martës, gazeta është bërë më pak e përulur ndaj Shtëpisë së Bardhë.

Nga ekonomia te morali: Ndryshimi i madh i politikës amerikane

Në vitin 1992, James Carville, strategu i famshëm politik i Bill Clintonit, përsëriste vazhdimisht sloganin: "It's the economy, stupid!" – "Është ekonomia, budalla!".

Mesazhi ishte i qartë: votuesit mendojnë mbi të gjitha për paratë dhe mirëqenien ekonomike.

Por në vitin 2026, kritiku Gal Beckerman i përgjigjet me një formulë të re: "It's the morality, stupid!" – "Është morali, budalla!". Morali po rikthehet në qendër të politikës amerikane.

Kjo ndodh pas një periudhe të shënuar nga kriptomonedhat e familjes Trump, shndërrimi i Uashingtonit në një lloj resorti pushimesh, komentet e presidentit për të pasmet e një kandidati, përçmimi i tij për barkun e një gazetari, postimet blasfemuese për Papën dhe Jezusin, si dhe një kulturë urrejtjeje e mbështjellë me shije të keqe dhe ekzagjerime vulgare.

Skandali Ramaswamy dhe neveria morale që përfshiu edhe republikanët

Nga Ohio, Vivek Ramaswamy, një figurë trumpiste e njohur për gafat e tij, publikoi një spot elektoral ku nëna e rivales demokrate Amy Acton akuzonte të bijën se gënjente. Por Ramaswamy kishte fshehur një fakt tronditës.

Gruaja nuk kishte pasur kontakte me të bijën prej dekadash, pas akuzave penale që lidheshin me abuzimet seksuale që kishte lejuar partneri i saj të kryente ndaj Amy Acton, kur kjo e fundit ishte vetëm 12 vjeçe.

Ky episod shkaktoi një valë neverie morale që tronditi edhe vetë Partinë Republikane.

Nikki Haley, ish-ambasadore amerikane, e cilësoi Ramaswamyn si "njeri të lig". Ish-guvernatori Chris Christie shpërtheu kundër asaj që e quajti "radiografia e imoralitetit", duke kritikuar edhe zëvendëspresidentin JD Vance, të cilin e përshkroi si "një katolik që mbron këtë akt të neveritshëm".

John Cornyn, konservatori teksan i poshtëruar nga Trumpi, kujtoi: "Karakteri dhe etika kanë rëndësi". Ndërkohë, familjarë të ish-presidentit George W. Bush votuan për Talaricon.

Edhe ish-deputetja Marjorie Taylor Greene bëri një rrëfim domethënës: "Unë isha një mbështetëse fanatike e MAGA-s. Por ata e kanë humbur ndjeshmërinë ndaj njerëzve të zakonshëm". Sipas saj, republikanët janë dehur nga pushteti i parasë.

Feja, solidariteti dhe rikthimi i ndjeshmërisë njerëzore

Pas vitesh talljesh me personat me aftësi të kufizuara, gratë, të moshuarit dhe të sëmurët, atmosfera politike duket se po ndryshon.

Në festën e fitores së James Talaricos këndohen këngë me mesazhe si: "Duaje të afërmin tënd". "Çdo vëlla është i shenjtë".



Ndërsa pastori Hamilton shpjegon për Christian Post se historia biblike e Samaritanit të Mirë nuk duhet parë thjesht si një shëmbëlltyrë fetare. Ajo duhet të kthehet në një program konkret politik: kujdes shëndetësor, ndihmë për pagesën e faturave dhe kupona ushqimorë për shtresat më të varfra.

"Paratë jashtë politikës!" Mesazhi i fitores në Detroit

Natën e 3 nëntorit, në Detroit, senatori i sapozgjedhur Abdul El-Sayed thërriste nga podiumi: "Paratë duhet të dalin nga…?!". Dhe turma e mbështetësve i përgjigjej e entuziazmuar: "Nga politika!".

"Dhe paratë duhet të shkojnë ku…?!", vazhdonte ai.

"Te qytetarët!", përgjigjej turma.

Më pas, doktori El-Sayed, myslimani i parë i zgjedhur në Senatin amerikan, e përmbyllte fjalimin me një mesazh: "Të besosh tek barazia, të drejtat, paqja, dinjiteti dhe vetëvendosja nuk është urrejtje. Është dashuri". Pas retorikës së testosteronit që Pete Hegseth u imponoi ushtarakëve, idealet e Butësisë dhe të Mëshirës të predikuara nga Jezusi në Predikimin në Mal po bëhen virale në TikTok.

Përçarja e MAGA-s dhe largimi nga Trumpi

Shpërbërja e unitetit të lëvizjes MAGA ka filluar tashmë. Zëvendëspresidenti JD Vance denoncon luftën në Iran. Senatori Ted Cruz rishfaqet me një ton të butë dhe pajtues. Por nga qendra e analizës së të dhënave të demokratëve, një veteran i fushatës presidenciale të John Kerryt i ofron autorit një krahasim interesant mes politikës dhe marketingut.

"Shiko rënien e tërheqjes së sektorit të luksit, i cili ka humbur 50 miliardë dollarë. Firmat e famshme, etiketat dhe markat e shtrenjta nuk e joshin më brezin Z, që është i apasionuar pas modës vintage, prirjeve të qëndrueshme dhe autenticitetit. E njëjta ndjenjë mbizotëroi edhe në zgjedhjet e mesmandatit. Teprimet nuk funksionojnë më. Kush e di se të çfarë marke janë rrobat që veshin Talarico dhe Hamilton?".

Trumpi nuk e kuptoi ndryshimin e shoqërisë amerikane

Mes apartamentit luksoz në Fifth Avenue, kompleksit Mar-a-Lago dhe fushave të golfit, Donald Trumpi nuk arriti të kuptonte ndryshimin e humorit të qytetarëve dhe konsumatorëve amerikanë.

Tani ai po e përtyp i vetëm këtë realitet të ri.

Ndërkohë, të martën, Elon Musk u bëri thirrje me entuziazëm ndjekësve të tij të votonin "Red", pra republikanët. Por më pas e fshiu postimin e nxituar, njësoj si një adoleshent që përpiqet të fshijë një mesazh të dërguar gabimisht te e dashura.

Shumë vonë, Elon!

Ata e panë mesazhin dhe votuan kundër teje.

Një gabim që kushtoi sa 77 milionë hamburgerë Big Mac.

Mësimi i Ronald Reaganit: Politika duhet t'u drejtohet vlerave më të mira të njerëzve

Në fjalimin e tij të fundit, presidenti Ronald Reagan kishte thënë: "Unë u jam drejtuar gjithmonë ndjenjave më të mira të votuesve, jo instinkteve të tyre më të këqija". Një mesazh historik që sot tingëllon si një kambanë paralajmëruese për Partinë Republikane, atë që njihet si Grand Old Party, partia e Abraham Lincolnit.

Sepse, pas një epoke kur dukej se miliarderët mund të blinin gjithçka, votuesit amerikanë kanë dhënë një mesazh tjetër: paratë mund të financojnë fushata, por nuk mund të blejnë ndërgjegjen, dinjitetin dhe besimin e njerëzve. / La Repubblica



Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Përcaktohen çiftet çerekfinale të Kupës së Kosovës në basketboll

Prishtinë, 6 nëntor - Janë përcaktuar çiftet çerekfinaliste të Kupës së Kosovës në basketboll për edicionin 2026/2027, ku tetë skuadra do të garojnë për katër vende në gjysmëfinale. Në këtë fazë të garës priten përballje interesante dhe rivalitet i madh, pasi skuadrat synojnë ta vazhdojnë rrugëtimin drejt trofeut të çmuar të Kupës së Kosovës, ka njoftuar FBK-ja.

Bashkimi do të përballet me Vëllaznimin, ndërsa Golden Eagle Ylli do të ketë për kundërshtar Borën.

Një nga përballjet më interesante të çerekfinaleve pritet të jetë ajo ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Trepçës, dy skuadrave me traditë në basketbollin e Kosovës.

Ndërkohë, Rahoveci 029 do të përballet me Pejën, në një tjetër duel që premton rivalitet dhe emocione.

Ndeshjet e para çerekfinale do të zhvillohen më 13 dhe 14 janar 2027, kurse ndeshjet e kthimit më 20 dhe 21 janar 2027.

Në gjysmëfinale do të përballen fituesi i ndeshjes Bashkimi - Vëllaznimi dhe fituesi i ndeshjes Rahoveci 029 - Peja, ndërsa në gjysmëfinalen tjetër do të përballen fituesit e ndeshjeve Golden Eagle Ylli - Bora dhe Sigal Prishtina - Trepça.

Ndeshjet çerekfinale dhe gjysmëfinale zhvillohen me nga dy ndeshje, në fushën e vendasve dhe të mysafirëve, ndërsa finalja zhvillohet me një ndeshje të vetme.



ÇIFTET ÇEREKFINALE TË KUPËS SË KOSOVËS:

Bashkimi - Vëllaznimi
Golden Eagle Ylli - Bora
Sigal Prishtina - Trepça
Rahoveci 029 - Peja

FODA PUBLIKON LISTËN E KOSOVËS PËR NDESHJET NDAJ IZRAELIT DHE IRLANDËS

Prishtinë, 6 nëntor - Përzgjedhësi i Kombëtares së Kosovës, Franco Foda, ka publikuar listën e futbollistëve të ftuar për dy ndeshjet e radhës në kuadër të Ligës së Kombeve. "Dardanët" do të përballen me Izraelin dhe Republikën e Irlandës, në dy sfida të rëndësishme për objektivat e tyre në këtë kompeticion.

Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka bërë me dije se skuadra do t'u hyjë këtyre përballjeve me motivim të lartë, përkushtim maksimal dhe shpirt luftarak, me synimin për të vazhduar me paraqitje dinjitoze dhe rezultate pozitive. Në listë ka tri prurje të reja. Bëhet fjalë për Lindrit Kamberin, Bleon Kurtulusin dhe Enis Rexhepin, të cilët ftohen për herë të parë në Kombëtaren e Kosovës.



SHQIPËRIA PUBLIKON LISTËN PËR DY NDESHJET E NËNTORIT

Tiranë, 6 nëntor - Kombëtarja shqiptare do t'i luajë dy ndeshjet e fundit të Grupit C1 në UEFA Nations League ndaj Finlandës dhe Bjellorusisë. Trajneri i kuqezinjve, Rolando Maran, ka publikuar listën me 27 futbollistët e grumbulluar për këto dy përballje të rëndësishme të muajit nëntor. Risia e vetme në këtë listë është mbrojtësi i Dinamo Cityt, Ysni Ismaili, i cili merr për herë të parë ftesën për t'u bashkuar me Kombëtaren shqiptare. Kuqezinjtë do ta nisin aventurën e nëntorit me



ndeshjen ndaj Finlandës, që do të luhet më 12 nëntor, në stadiumin "Air Albania", në orën 20:45. Më pas, Shqipëria do të udhëtojë drejt Budapestit, ku më 15 nëntor do të përballet me Bjellorusinë, në stadiumin "Illovszky Rudolf", në orën 18:00.

Pasi ka publikuar listën, selektori i Kombëtares së Shqipërisë, Rolando Maran, ka folur në konferencën për medie për grumbullimin e këtij muaji, i cili nis të hënën.

Maran ka thënë se synon që sezonin ta mbyllë në këtë pozitë për t'u promovuar në Ligën B sezonin tjetër. "Presioni është pozitiv, duam të bëjmë mirë, të mbyllim mirë këtë grup, në kryesim. Kemi të gjitha mundësitë ta bëjmë. Jemi me motivimin e duhur", ka thënë Maran.

Ai ka insistuar me bindje të plotë se ka bërë listën e duhur për këto dy përballje dhe ka thënë se stërvitjen e së hënës do ta mbajë me dyer të hapura, duke mirëpritur të gjithë tifozët. "Jemi të parët në çdo të dhënë në Ligën C. Në të gjithë Ligën C jemi të parët me gola në favor. Jemi ata që kemi pësuar më pak aksione kundër, të parët jemi edhe me gjuajtjet në portë", ka shtuar Maran.

LISTA E FUTBOLLISTËVE:

Portierë: Etrit Berisha, Alen Sherri dhe Mario Dajsinani.

Mbrojtës: Berat Gjimshiti, Arlind Ajeti, Ardian Ismajli, Klisman Cake, Samuele Sina, Elseid Hysaj, Ysni Ismaili, Mario Mitaj, Stavro Pilo dhe Naser Aliji.

Mesfushorë: Kristjan Asllani, Ylber Ramadani, Qazim Laçi, Juljan Shehu, Luis Hasa, Feta Fetai, Klevi Qefalija, Ernest Muçi, Arbër Hoxha dhe Taulant Seferi.

Sulmues: Rey Manaj, Myrto Uzuni, Mirlind Daku dhe Cristian Shpendi.

HARRY KANE BËHET LOJTARI MË I PAGUAR TE BAYERN MUNICHU



Bayern, 6 nëntor - Harry Kane ka vazhduar kontratën me Bayern Munichun deri në vitin 2029, ndërsa marrëveshja e re e ka bërë atë futbollistin më të paguar në klubin bavarez. Sipas gazetarit të "Sky Sport", Florian Plettenberg, sulmuesi anglez 33-vjeçar do të përfitojë më shumë se 30 milionë euro bruto në vit, duke përfshirë edhe bonuset e mundshme. Me këtë marrëveshje Kane e ka kaluar në listën e pagave edhe Jamal Musialan, i cili deri më tani ishte futbollisti më i paguar i Bayernit. Madje, sipas Plettenbergut, kontrata e re e anglezit renditet në mesin e tri marrëveshjeve më fitimprurëse në futbollin evropian. Përveç pagës bazë, Kane do të ketë mundësi të përfitojë bonuse të konsiderueshme, në varësi të suksesit individual dhe ekipor. Ai mund të shpërblehet financiarisht për fitimin e trofeve vendorë, triumfin në Ligën e Kampionëve dhe fitimin e mundshëm të Topit të Artë. Gjithashtu, në llogaritjen e bonuseve do të përfshihen edhe statistikat personale, veçanërisht nga numri i golave dhe asistimeve.

Ndërkohë, janë zbuluar edhe dy hollësi të tjera të rëndësishme të kontratës së re: ajo nuk përmban klauzolë lirimi dhe as mundësi për vazhdim të mëtejshëm përtej vitit 2029. Kështu, Bayern Munichu ka siguruar vazhdimësinë me njërin prej futbollistëve më të rëndësishëm të skuadrës, duke e shpërblyer me një kontratë që e vendos në majën e hierarkisë financiare të klubit.

Lutfi Dalipi refuzon Zvicrën, tash Kosova dhe Shqipëria në garë për ta bindur

Lutfi Dalipi po shkëlqen me fanellën e Vaduzit, ku këtë sezon ka shënuar pesë gola dhe ka dhënë nëntë asistime në 12 ndeshje të Superligës së Zvicrës.Sulmuesi 20-vjeçar, me prejardhje nga Kosova dhe Portugalia, ka vendosur të mos e përfaqësojë më Zvicrën. Sipas mediave zvicerane "Blick" dhe "20 Minuten", ai e ka njoftuar përzgjedhësin e Zvicrës U21, Alex Frei, për vendimin e tij.Dalipi dëshiron të luajë për Kosovën ose Shqipërinë, por ende nuk ka vendosur se cilën përfaqësuese do ta zgjedhë. Vendimi i tij lidhet me rrënjët dhe prejardhjen familjare. Paraqitjet e tij kanë zgjuar interesimin edhe të klubeve të Bundesligës gjermane dhe Serisë A italiane.







Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me operatorin "Geo-Mineral'' Sh.p.k. Prishtinë për vazhdim të Lejes Mjedisore, me nr. prot. 25/8272/MMPH, për Eksploatim të gurit gelqeror ne Rahovec dhe Astrazub, Malishevë, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 03.12.2026, në ora: 10:00, në hapësirat e Zyret e kompanisë "Geo-Mineral'' Sh.p.k., do të organizohet debat publik nga operatori "Geo-Mineral'' Sh.p.k. Prishtinë për vazhdim të Lejes Mjedisore, me nr. prot. 25/8272/MMPH, për Eksploatim të gurit gelqeror në Rahovec dhe Astrazub, Malishevë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

ID:
https://us04web.zoom.us/j/5289487423?pwd=atEPUrNDxCwMcX5GSCHJS7NmAu7JDN.1
Passcode:pa passcod


Linku i Komunës:

Linku i gazetës ditore:

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPH-së, për komente të publikut:
https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=MATR
Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.
Me respekt,

Sami Heta , Drejtor i kompanisë

"Geo-Mineral'' Sh.p.k.,



Zvogëlim i kapitalit nga firma EUROFAMIS Sh.A

Firma "EUROFAMIS" Sh.A, me numër UNIK IDENTIFIKUES, NUI: 811306431, me seli në Shirokë, Suharekë, bën zvogëlimin e kapitalit nga vlera 910.000,00 euro në vlerën 10.000,00 euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Milazim Dana shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K "11 Marsi " Prizren.

- Trim Rezniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p "Gjon N. Kazazi" Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

Shoqata Humanitare Bamirëse e Kosovës "Nëna Terezë"
The Kosova Humanitarian and Charitable Society "Mother Tereza"
Humanitarno Dobrotvorno Udruzenja Kosova "Majka Tereza"
38400 Prishtinë Rr. Agim Ramadani pn. Tel:00381 38 542 864, Fax: 542 869,
Web site: www.nenaterezë.org e_mail:nterezë@yahoo.com

CONTRACT NOTICE

SUPPLIES

According to Article 40 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 09/11/*2026*

Procurement No	**Tools/Equipment-**	**002**	**2026**	**111**

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English ☒

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name:Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
Postal address: str. Mujë Krasniqi n.n Ulpiana U1/1		
Town: *Pristina*	Postal code:10000	Country: Kosovo
Contact point(s): Zef Shala		Telephone:038-542-865
Email: zefshala@hotmail.com		Fax:038-542-869
Internet address (*if applicable)*:		www.motherteresasociety.org

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority:
"Supplies with tools / equipment for 560 beneficiaries"

II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance
(Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)

	☒**Supplies**	
	Main Place of Delivery As specified by the Contracting Authority.	

II.1.5) Short description of the object of the contract
Supplies with tools/ equipment for 560 beneficiaries

II.1.6) Common Procurement Vocabulary classification (CPV)
☐**93.000.000.08**☐

II.1.7) Variants are accepted

II.1.8) Division into lots **No** ☒
If yes, tenders may be submitted for *(tick one box only)*
☐ All sectors

II.1.9) In case of one or more Lots (*if applicable)*

The maximum number of sectors that may be awarded to one Economic Operator is: *[1]*

II.1.10) Information about lots (*if applicable)*

Sector No.	Short Description
1	**701 - Non-wood forest products (NWFP) including medicinal and aromatic plants (MAP), mushrooms and ornamental plants**
2	**702 - Agritourism**
3	**703 - Processing of agricultural products on farm**
4	**704 - Honey production**
5	**705 - Non-agricultural activities**
6	**706 - Poultry growing for egg and meat production**
7	**707 - Aquaculture**
	Further details are provided in the Tender Dossier.

II.1.11) Estimated contract value: 1,400,000.00 Euro

II.2) QUANTITY OR SCOPE OF THE CONTRACT
II.3) DURATION OF THE CONTRACT OR TIME LIMITS FOR COMPLETION

Duration in months 5 *or* days 150 (from the contract signature)
or
Starting **15/01/2027**
Completion **14/06/2027**

SECTION III: LEGAL, ECONOMIC, FINANCIAL AND TECHNICAL INFORMATION

III.1) CONDITIONS RELATING TO THE CONTRACT

III.1.1) Performance security required **No** ☐

III.1.2) Legal form to be taken by grouping of economic operators to whom the contract is to be awarded *(if applicable)*

III.1.3) Other conditions to which performance of the contract is subject **No** ☐

III.2) CONDITIONS FOR PARTICIPATION

III.2.1) Eligibility Requirements:
1. Certificate of Business Registration
2. Fiscal Number Registration Certificate
3. VAT Certificate (if applicable)

Documentary evidence required
Copy of documentary

III.2.2) Professional Suitability:
1. License Registration Certificate.
2. List of employees, including professional and administrative staff, with individual CVs,
3. List of transport vehicles
4. Copies of reference letters or copies of contracts, along with a list of similar implemented projects.

Documentary evidence required:
Copy of documentary

III.2.3) Economic and financial capacity
1. Certificate issued by the competent judicial authority confirming that the company and its legal representative are not involved in any legal proceedings (required only for the awarded company).
2. Company profile.
3. Tax Verification Certificate issued by the Tax Administration of Kosovo confirming that the company has fulfilled its tax obligations (required only for the awarded company).
4. Bank Certificate confirming that the company holds an active bank account (required only for the awarded company).

Documentary evidence required:
Copy of documentary

III.2.4) Technical and professional capacity
Documentary evidence required
Copy of documentary

III.3) CONDITIONS SPECIFIC TO SERVICE CONTRACTS

III.3.1) Execution of services is reserved to a particular profession **No** ☒

III.3.2) Legal persons should indicate the names and professional qualifications of the staff responsible for the execution of the supplies **Yes** ☒

SECTION IV: PROCEDURE

IV.1) TYPE OF PROCEDURE

IV.1.1) Type of Procedure

☒**Open**

IV.2) AWARD CRITERIA

Lowest price meeting the Eligibility Criteria and Required Documentation

IV.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

IV.3.1) Previous publications concerning the same contract **No** ☒

IV.3.2) Conditions for obtaining *tender dossier*
Time limit for receipt of requests for ***tender dossier***: **date from 10/11/2026 until 16/11/2026**

Payable documents **No** ☒

IV.3.3) Time limit for receipt of *tender:*
Date 21/12/2026 time14:00place Office of Mother Teresa Society Prishtina

IV.3.4) Time limits is shortened for submission of *tender* ☒ No

IV.3.5) Is tender security needed: **No** ☒

IV.3.6) Tender validity period: Date:21/12/2026 days 30 or months 1-one

IV.3.7) Tender opening meeting:

Date 21/12/2026 time 14:30place MTS Office Prishtina

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092,at the address specified in Section I of this Contract notice.

V.2) ADDITIONAL INFORMATION

Note: Economic operators will be entitled to submit a tender, request to participate and other documents required or permitted to be filed during the conduct of a procurement activity in English.


MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES


100%
Fresh &
Natural
VIDAS
Llatte
drink
2%
TAMËL
PRODHUAR ME
FINESË DHE DASHURI
2,8%
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
JOGURT
DHALLË


ROYAL CROWN
RC
cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L